



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-024

Prishtinë, më 5 korrik 2011, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 5 KORRIK 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Burim Ramadani dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 qershor 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 qershor 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 qershor 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare që do të mbahet më 8 korrik 2011.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 8 korrik 2011, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Pika shitesë:

1. Informata e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me skadimin e mandatit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Informatën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që të udhëheqë me procedurat për emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, në pajtim me Ligjin e Agjencisë kundër Korrupsionit, si dhe Vendimin e mbledhjes plenare Nr. 04-V-007, të datës 10 mars 2011.

2. I rekomandohet Komisionit për Legjislacion që në konsultim me drejtorin aktual të autorizojë me shkrim njërin nga varësit e tij/saj të drejtpërdrejtë për ta zëvendësuar deri në emërimin e drejtorit të ri të Agjencisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:50** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.